

## AKT THEMELIMI

### PER SHOQERINE "Edisud RADIO-TV" SHPK TIRANE



Sot, me daten 26.03.2002, ortakut i vetem shoqeria "Edisud" S.p.A., me seli ne Bari ITALI, ruga "Scipione Africano".nr.264, perfaqesuar me prokure te posame prokure te posaçme nga Z. Carlo Bolino, me prokuren nr..... e dates..... mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" krijon nje shoqeri tregtare me kushtet si me poshte:

#### Neni 1

Themelohet shoqeria tregtare me emertimin shoqeria " Edisud RADIO -TV" SHPK, me poshte e quajtur thjesht shoqeria, me ortak te vetem themelues shoqerine "Edisud" S.p.A. Bari Itali.

#### Neni 2

Shoqeria eshte person juridik shqiptar. Ajo e ka seline ne Tirane, Rruga e Kavajes nr.17.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese, duke respektuar procedurat ligjore ne fuqi.

#### Neni 3

Shoqeria e shtrin veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te çele perfaqesi, dege agjenci apo filiale te saj edhe jashte Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

#### Neni 4

Shoqeria eshte themeluar per te vepruar pa afat te caktuar.

#### Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:  
Ushtrimi i veprimtarise ne fushen radiotelevizive

#### Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 25 000 000 (njetzetepesemilion ) leke. Ai perbehet nga kontributet ne para si dhe nga kontributet ne natyre. Kontributet ne para jane ne masen 19 000 000 (nentembedhjetemilion) leke ndersa kontributet ne natyre jane 6 000 000 ( gjashtemilion ) leke. Kontributet ne natyre perfaqesojne pajisjet per transmetimin radioteleviziv te vleresauara sipas raporteve te eksperteve te kontributeve e te ekspertit kontabel, qe u bashkelidhen akteve te themelimit.

#### Neni 7

Kapitali themeltar ndahet ne 25 000 ( njetzetepesemije ) pjese te barabarta dhe zoterohet ne masen 100% nga ortakut i vetem shoqeria "Edisud" S.p.A. Bari Itali.

Neni 8

Kapitali themeltar eshte plotesisht i likujduar dhe ortaku i vetem zoteron lirisht te gjitha pjeset e barabarta.

Neni 9

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja e ortakeve

Administratoret

Neni 10

Norma te hollesishme per veprimtarine e organeve drejtuese percaktohen ne Statutin e shoqerise.

Neni 11

Veprimtaria e shoqerise pasqyrohet ne bilancet financiare qe hartohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Fitimi i rezultuar nga veprimtaria vjetore, mbas zbritjes se rezervave ligjore dhe atyre te percaktara nga Asambleja, ndahet ne forme dividenti, per ortaket e shoqerise, sipas % qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.

Neni 12

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 13

Shoqeria mund te mbylle veprimtarine e saj me vendim te Asamblese dhe ne baze te ligjit.

Mbyllja e veprimtarise se shoqerise behet ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 14

Dispozita te hollesishme per veprimtarine e shoqerise dhe te organeve drejtuese te saj percaktohen ne Statut.

ORTAKU I VETEM

SHOQERIA "EDISUD" S. p.A

..... (ALLI BOLLIN) .....

EBD

# STATUTI

## I SHOQERISE "Edisud RADIO - TV" SHPK TIRANE



Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992"Per shoqerite tregtare" dhe te Aktit te Themelimit te shoqerise "Edisud TV"SHPK , ortaku i vetem themelues miraton kete Statut per veprimtarine e shoqerise

### Neni 1

Ortaku i vetem shoqeria "Edisud "S.p.A. Bari Itali themelon shoqerine "Edisud RADIO - TV"", me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

### Neni 2

Ortak themelues i vetem i shoqerise eshte shoqeria "Edisud"S.p.A., me seli ne Bari Itali, rruga " Scipione Africano.." nr.264.

### Neni 3

Shoqeria eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj bazohet ne legjislacionin ne fuqi, ne normat e percaktuara ne kete Statut dhe ne Vendimet e Asamblese se ortakeve.

### Neni 4

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, ne rrugen e Kavajes nr.17.. Selia e shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

### Neni 5

Shoqeria e shtrin veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te çele zyra perfaqesimi, agjensi, dege e filiale te saj edhe ne vende te tjera, duke respektuar legjislacionin e vendit perkates.

### Neni 6

Shoqeria eshte krijuar per te vepruar per nje kohe te pacaktuar.

### Neni 7

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ne fushen raditelevizive

### Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 25 000 000 (njetepesemilion ) leke. Ai perbehet nga kontributet ne para ne masen 19 000 000 (nentembedhjetemilion ) leke dhe ne kontributet ne natyre ne masen 6 000 000 ( gjashtemilion ) leke.. Kapitali ne para eshte i likujduar plotesisht ne banke nders kapitali ne natyre eshte sipas vleresimit te ekspertit te kontributeve dhe ekspertit kontabel.

**Neni 9**

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 25 000 ( njezetepesemije ) pjese te barabarta, secila me vlere nominale prej 1 000 ( njemije ) leke.

**Neni 10**

Kapitali themeltar zoterohet teresisht nga ortaku i vetem, shoqeria "Edisud" S.p.A., Bari Itali.

**Neni 11**

Kapitali themeltar mund te ndryshoje, te rritet apo zvogelohet, duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

**Neni 12**

Pjeset e barabarta te kapitalit themeltar jane te tregtueshme lirisht.

**Neni 13**

Organet drejtuese te shoqerise jane:  
Asambleja e ortakeve,  
Administratoret.

**Neni 14**

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte drejtues i shoqerise. Ajo perbehet nga teresia e ortakeve qe zoterojne pjese te barabarta ne kapitalin themeltar te shoqerise, Meqenese kapitali themeltar zoterohet nga ortaku i vetem, shoqeria "Edisud" S.p.A. Bari Itali, asambleja do te jete e perfaqesuar nga personi i autorizuar me prokure nga kjo e fundit.

**Neni 15**

Asambleja e ortakeve eshte e Zakonshme dhe e Jashtezakonshme.

Asambleja e Jashtezakonshme vendos per ndryshimin e kapitalit, per çdo ndryshim ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut si dhe per çdo gje qe ne baze te ligjit eshte ne kompetence te saj.

Asambleja e Zakonshme vendos per gjithë çeshtjet e tjera te shoqerise.

**Neni 16**

Te drejten e thirrjes se mbledhjes se Asamblese e ka çdo ortak qe zoteron jo me pak se 5% te pjeseve te barabarta te kapitalit themeltar, administratoret si dhe personat e percaktuar ne baze te ligjit apo me vendim te Gjykates.

**Neni 17**

Asambleja thirret ne mbledhje jo me pak se 1 here ne vit. Mbledhja e Asamblese behet zakonisht prane selise se shoqerise. Ajo mund te behet edhe ne çdo vend

*EB/16*

tjeter, por gjithmone ne qytetin e Tiranes, me kusht qe vendi te jete percaktuar saktesisht ne njoftimin per mbledhje dhe te mos jete banese private.

Neni 18

Njoftimi per mbledhjen e Asamblese duhet t'u dorezohet ortakeve jo me von se 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese. Kur ortaku eshte person juridik dorzimi i njoftimit per mbledhjen e Asamblese por dhe i çdo komunikimi tjeter do te behet ne seline e shoqerise ose ne adresen e percaktuar me shkrim nga vete ortaku. Kur ortaku eshte person fizik dorzimi i njoftimit per mbledhjen e Asamblese behet ne adresen e percaktuar nga vete personi. Shenimi i postes, kur ne adresat e percaktuara si me siper nuk ka njeri, eshte i vlefshem per ta konsideruar te realizuar komunikimin.

Neni 19

Lajmerimi per mbledhjen e Asamblese duhet te permbaje rendin e dites, daten dhe oren e mbledhjes, vendin e mbledhjes. Ne rastet e Asamblese se Jashtezakonshme kjo duhet te shprehet ekzakesisht.

Neni 20

Pergatitja per mbledhjen e Asamblese eshte ne ngarkim te atyre qe kerkojne thirrjen e saj. Ne te gjitha rastet administratoret jane te detyruar te marrin masat per realizimin e mbledhjes se Asamblese.

Neni 21

Dokumentat qe do te shqyrtoje Asambleja vihen ne dispozicion te ortakeve, ne seline e shoqerise jo me von se 5 dite para mbledhjes se Asamblese.

Neni 22

Ne mbledhje te Asamblese mbahet procesverbal , i cili nenshkruhet nga ortaket pjesmarres dhe sekretari.

Neni 23

Asambleja eshte e vlefshme ne rast se permbushen kushtet e kerkuara nga ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Vendimet e Asamblese merren me shumicen e votave sipas percaktimeve ne dispozitat ligjore per shoqerte tregtare.

Neni 24

Veprimtaria e zakonshme e shoqerise drejtohet nga administratori. Administratori emerohet nga Asambleja per nje periudhe 3 vjeçare.

Neni 25

Administrator i shoqerise, per periudhen e pare tre vjeçare, emerohet Znj. Lindita Dode.



**Neni 26**

Administratori është perfaqësues ligjor i shoqërisë dhe ka në kompetencë të gjitha çështjet që lidhen me administrimin e shoqërisë, me përjashtim të atyre që ligji i përcakton si kompetencë të Asamblesë.

**Neni 27**

Marredhënie të punës me shoqëri janë në kompetencë të administratorit dhe rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 28**

Administratori i shoqërisë është perfaqësues ligjor i shoqërisë në marredhënie të saj me gjithë personat e tretë dhe me organet shtetërore e gjyqësore.

**Neni 29**

Veprimtaria financiare e shoqërisë pasqyrohet në bilancet financiare. Ushtrimi financiar fillon me datën 01 Janar dhe mbaron me datën 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përjashtim viti i fillimit të veprimtarisë, në të cilin si datë fillimi do të merret ajo e regjistrimit në organet kompetente.

**Neni 30**

Ortaket janë përgjegjës për humbjet që rezultojnë nga veprimtaria e shoqërisë deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 31**

Administratori është përgjegjës për hartimin e bilancit e të llogarive vjetore të shoqërisë. Kur është rasti Asambleja emeron dhe ekspertin kontabel të autorizuar.

**Neni 32**

Fitimet që rezultojnë nga veprimtaria e shoqërisë, mbas zbritjes së rezervave ligjore, ndahen sipas vendimit të Asamblesë.

**Neni 33**

Shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj kur janë rastet e parashikuara në ligj apo me vendim të Asamblesë së oratkeve.

**Neni 34**

Në çdo rast të mbylljes së veprimtarisë së shoqërisë zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.

**Neni 35**

Në rastin e mbylljes së veprimtarisë së shoqërisë, vlera e pasurisë që mbetet, pas likuidimit të gjithë detyrimeve, ndahet ndërmjet ortakëve, në përputhje me përqindjen e pjesëve të barabarta të kapitalit themeltar që ata zotërojnë në momentin e marrjes së vendimit për mbyllje.

Neni 36

Per çdo gje që nuk është shprehur posaçërisht në këtë Statut i referohet dispozitave ligjore për shoqëritë tregtare, pjesë për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.



ORTAKU I VETEM THEMELUES

SHOQERIA "EDISUD" S.p.A

*CARLO BOLLINO*

*CB*

Me 27.03.2002

# STATUT

## **EMËRTIMI-OBJEKTI-VENDNDODHJA-KOHËZGJATJA**

**Neni 1- Krijohet një Shoqëri Aksionere me emrin “Societa per Azioni Editrice del Sud (Edisud)”.**

**Neni 2- Shoqëria ka për objekt:**

**- Drejtimin për vete ose për llogari të të tretëve të aktiviteteve botuese dhe tipografike të të gjitha llojeve; si dhe aktivitetet radio-televiziv dhe reklame. Shoqëria mund të blejë edhe pajisje dhe mjete për aktivitetet e mësipërme.**

**Vetëm në përputhje me objektin e shoqërisë të përcaktuar më sipër dhe brenda kufijve të tij, Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, bankare, shitblerje pronash të tundshme dhe të patundshme që Organi Administrativ i konsideron të nevojshme, përfshirë këtu dhe pjesëmarrjen në shoqëri apo sipërmarrje të tjera me objekt të njëjtë ose të përafërt dhe e gjitha në përputhje me ligjet në fuqi.**

**Neni 3 - Shoqëria e ka qendrën në Bari në rrugën Scipione l’ Africano nr.264. Shoqëria është e lirë të hapë kudo filiale, agjensi dhe zyra përfaqësimi dhe t’i mbyllë ato. Vetëm aktiviteti industrial zhvillohet në zonat e Mezzogiorno d’Italia.**

**Neni 4 - Vendndodhja e ortakëve për çka lidhet me raportet e tyre me Shoqërinë konsiderohet vetëm ajo që rezulton e shkruar në Librin e Ortakëve.**

**Neni 5 - Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar deri në 31 dhjetor 2050 dhe mund të zgjatet.**

## **KAPITALI**

**Neni 6- Kapitali është përcaktuar në lira 2.000.000.000 (dymiliardë) dhe ndahet në 200.000 (dyqindmijë) aksione nga 10.000 (dhjetëmijë) lireta secili.**

**Neni 7 - Shoqëria është e lirë të grumbullojë pranë ortakëve të saj, fondet e nevojshme për zbatimin e Objektivit të Shoqërisë sipas afateve dhe modaliteteve të dekretit legjislativ të datës 01.09.1993, nr.385 dhe Vendimit të Komitetit Ndërmënishtor për Kreditë dhe Kursimin (C.I.C.R.) të datës 03.03.1994 dhe/ose të vendimeve të mundshme të marra më pas nga ky Komitet.**

**Kapitali mund të rritet edhe me emetimin e aksioneve të privileguara ose që kanë të drejta të ndryshme nga aksionet e mëparëshme.**

**Lejohen gjithashtu kalim të të mirave materiale në natyrë dhe të kredive (përfshirë tituj) në përputhje me ligjin.**

**Neni 8- Derdhjet që lidhen me kapitalin e Shoqërisë kërkohen nga Këshilli Administrativ në afatet dhe mënyrat që i konsideron të përshtatshme sipas normave ligjore që ekzistojnë për këtë qëllim. Në ngarkim të ortakëve që vonojnë derdhjet aplikohet interesi vjetor prej 5% (pesë përqind), me përjashtim të sa është përcaktuar në nenin 2344 të Kodit Civil.**



**Neni 9-** Ortaku që dëshiron të transferojë aksionet e veta të gjitha ose pjesërisht duhet të njoftojë me letër rekomande me faturë kthimi Presidentin e Këshillit Administrativ, duke i bërë të ditur sasinë e aksioneve të nxjerra në shitje dhe çmimin përkatës.

Brenda 10 ditësh nga marrja e këtij komunikimi, Presidenti i Këshillit Administrativ informon ortakët e tjerë. Këta mund të blejnë aksionet e ofruara, me çmimin e përcaktuar, në proporcion me aksionet që kanë në datën në të cilën oferta i ka ardhur nga shoqëria; kështu ortakët që duan të ushtrojnë të drejtën e parablerjes duhet të njoftojnë Presidentin e Këshillit Administrativ, gjithmonë me mënyrën e letrës rekomande me faturë kthimi brenda 30 ditësh nga koha kur morën njoftim, duke përcaktuar në mënyrë të qartë nëse duan ta ushtrojnë këtë të drejtë edhe për pjesën e aksioneve eventualisht jo të kërkuar nga ortakët e tjerë. Në rastin kur shumë ortakë deklarohen të gatshëm të blejnë aksionet jo me të drejtë parablerje, e drejta e blerjes mbetet gjithmonë në përpjestim me aksionet e secilit, veç nëqoftëse nuk ka ndonjë marrëveshje tjetër midis kërkuesve.

Me përfundimin e kohës siç u përmend më sipër, aksionet për të cilat nuk është zbatuar e drejta e parablerjes i kalojnë lirisht të tjerëve maksimumi tre muajt pasues dhe me një çmim jo më të vogël se ai i kërkuar nga ortakët e tjerë.

Në rast se një ortak dëshiron ta kalojë tërë bllokun e aksioneve që posedon dhe këtë e thekson në komunikatën e ofertës që shitja duhet të bëhet në bllok, e drejta e parablerjes nga ortakët e tjerë do të jetë e vlefshme dhe efikase nëqoftëse zbatohet për të gjitha aksionet e ofertuara. Është totalisht e pavlefshme për shkak të shkeljes së nenit 2355, pika 3 e Kodit Civil, çfarëdo shprehje aksionesh e kryer jo në përputhje me klauzolat e sipërpërmendura.

E drejta e parablerjes nuk aplikohet për transferimin që i bëhen bashkëshortit, paraardhësve ose pasardhësve të tij në linjë të drejtpërdrejtë deri në shkallën e dytë si pasojë e vdekjes.

E drejta e parablerjes nuk aplikohet gjithashtu në rastin e kalimit të aksioneve nga ana e një aksionieri, një shoqërie në të cilën po ky person ka shumicën absolute.

## ASAMBLEJA

**Neni 10 -** Asambleja përfaqëson bashkësinë e ortakëve, vendimet e saj të marra në përputhje me Ligjin dhe këtë Statut. Ajo merr vendime të detyrueshme për të gjithë ortakët. Mbledhja e Asamblesë është e zakonshme ose e jashtëzakonshme në përputhje me Ligjin dhe zhvillohet në vendndodhjen e Shoqërisë ose sidoqoftë në Itali.

Kur rrethana të veçanta e kërkojnë, mbledhja e zakonshme e Asamblesë mund të thirret nga Këshilli Administrativ brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit ushtrimor, në përputhje me nenin 2364 të Kodit Civil.

**Neni 11- Çdo aksion të jep të drejtën e një vote.**

**Neni 12-** Mbledhjet e Asamblesë bëhen mbas publikimit të njoftimit që përmban rendin e ditës në "Gazeta Zyrtare" jo më pak se 15 ditë pune përpara se asaj të fiksuar për mbledhje. Në të njëjtin njoftim mund të fiksohet për ditën tjetër, edhe për atë mbrapa, mbledhja e dytë kur e para nuk është zhvilluar.

Gjithsesi janë të vlefshme edhe mbledhjet e Asamblesë edhe në qoftë se nuk janë thirrur në mënyrën e sipërpërmendur, por gjithsesi përfaqësohet i gjithë kapitali i shoqërisë dhe asistojnë të gjithë administratorët e deleguar dhe revizorët efektivë.

**Neni 13-** Për të qenë të zgjedhur në Asamble ortakët duhet të depozitojnë titujt e aksioneve të tyre në vendet e përcaktuara në njoftimin e mbledhjes jo më vonë se pesë ditë pune nga data e vendosur për mbledhje ose në vendndodhjen e shoqërisë.

**Neni 14-** I takon Presidentit të Asamblesë të vendosë të drejtën e ndërhyrjes dhe të delegimit.

**Neni 15-** Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga Presidenti i Këshillit Administrativ ose nga persona të tjerë të vendosur nga vetë Këshilli. Në mungesë të tyre Asambleja e zgjedh vetë Presidentin e saj.

**Neni 16-** Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme nëqoftëse janë të pranishëm dhe votojnë pro shumica sipas nenit 2368 të Kodit Civil, dhe/ose në rast të një thirrje të dytë, sipas nenit 2369 të Kodit Civil.

**Neni 17 -** Mbledhja e Asamblesë emëron një Sekretar, që mund të mos jetë ortak dhe cakton, nëqoftëse e shikon të nevojshme, midis aksionerëve ose revizorëve dy numërues votash.

Vendimet e Mbledhjes së Asamblesë mbahen me procesverbal të firmosur nga Presidenti, Sekretari dhe në rast se ka nga numëruesit e votave.

Në përputhje me ligjin dhe kur Këshilli e konsideron të nevojshme, procesverbali hartohet nga Noteri i zgjedhur nga Presidenti i Këshillit Administrativ ose nga ai që e zëvendëson.

## KËSHILLI ADMINISTRATIV

**Neni 18-** Shoqëria administrohet nga një Këshill Administrativ i përbërë nga jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 9 anëtarë, kohëzgjatja në detyrë e të cilëve është tre vjet dhe ata mund të rizgjidhen.

**Neni 19-** Vendosja e numrit të përbërësve të Këshillit Administrativ bëhet pas çdo rinovimi të Asamblesë së Zakonshme të Aksionistëve.

**Neni 20-** Këshilli Administrativ zgjedh në mes të anëtarëve të tij Presidentin dhe një ose më shumë Këshilltarë të Deleguar dhe eventualisht edhe Zv/presidentin. Këshilli Administrativ emëron edhe Sekretarin.

**Neni 21-** Këshilli Administrativ mblidhet sa herë që Presidenti e gjykon të nevojshme ose kur kërkohet me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të tij.

**Neni 22-** Këshilli Administrativ thirret nga Presidenti me letër rekomande të nisur të paktën 5 ditë përpara mbledhjes çdo anëtar dhe revizori efektiv dhe në raste urgjente me telegram të nisur të paktën dy ditë përpara.

**Neni 23-** Për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit Administrativ kërkohet prezenca efektive e shumicës së anëtarëve të zgjedhur të tij. Vendimet merren me shumicë absolute vote të anëtarëve prezentë.

**Neni 24-** Anëtarëve të Këshillit iu rimbursohen shpenzimet e bëra për arsye pune. Asambleja për më tepër mund t'i japë Këshillit të Administrimit një kompensim vjetor.

**Neni 25-** Këshillit Administrativ i jepen kompetencat më të mëdha për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë pa asnjë përjashtim dhe ka për detyrë të nxjerrë të gjitha aktet që i konsideron të nevojshme për vënien në jetë dhe realizimin e qëllimeve të Shoqërisë, përjashtuar vetëm ato që me ligj janë kompetencë e Asamblesë.

Këshilli ka kështu, midis të tjerash të drejtën për të blerë, shitur dhe shkëmbyer pasuri të patundshme t'i kalojë ato në shoqëri të tjera të themeluara ose në themelim, të ketë pjesëmarrje dhe interesa për të kryer sipas nenit 2 të këtij Statuti regjistrime, anulime, vërtetime ipotekore, të heqë dorë nga ipotekat e ligjshme dhe të çlirojë Përgjegjësin e regjistrimit të pasurive të patundshme nga Përgjegjësitë.

**Neni 26-** Këshilli Administrativ mund t'i japë detyra speciale Administratorëve të Deleguar për të emëruar përfaqësues, duke fiksuar pagat dhe shpenzimet, prokurues ad-negotia për akte të veçanta ose kategori të ndryshme aktesh, si dhe prokurues special.

Këshilli Administrativ mund të emërojë një Komitet Ekzekutiv të përbërë nga tre ose pesë Këshilltarë, duke përcaktuar të drejtat dhe shpërblimet e tyre. Vendimet e Komitetit Ekzekutiv merren me shumicë votash.

Këshilltari i Deleguar ose Këshilltarët e Deleguar, nëse janë të emëruar mund të kryejnë të gjitha funksionet që përmbahen në objektin e shoqërisë, në përputhje me nenin 2384 të Kodit Civil, me përjashtim të dispozitave të nenit 2381 të Kodit Civil.

Në mënyrë të specifikuar Këshilltarit të Deleguar ose Këshilltarëve të Deleguar i atribuohen të gjitha kompetencat sipas nenit 25 të këtij Statuti me përjashtim të kompetencave që më lart i janë dhënë Komitetit Ekzekutiv.

**Zgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm të Gazetës dhe e drejtuesve të lartë janë kompetencë ekskluzive e Këshillit Administrativ.**

Këshilltarit ose Këshilltarëve të Deleguar mund t'i atribuohen edhe kompetenca të tjera në përputhje me nenin 27 të këtij Statuti, përjashtuar kompetencat e Presidentit të Këshillit Administrativ, përfshirë të drejtën e emërimit të përfaqësuesve, prokuruesve ad-negotia për akte të përcaktuara ose kategori aktesh, si dhe prokurues specialë.

## **FIRMA DHE PËRFAQËSIA E SHOQËRISË**

**Neni 27-** Përfaqësimi i shoqërisë bëhet me firmë të lirë të Presidentit për ekzekutimin e të gjithë vendimeve të Këshillit Administrativ. I takon gjithashtu atyre personave edhe jashtë Këshillit, por të caktuar nga ky këshill në kuadrin e kompetencave që atyre iu atribuohen me modalitetet e të drejtës së firmës, që u jepet me aktin e emërimit.

Presidentit i takon të përfaqësojë Shoqërinë duke ndërmarrë veprime juridike dhe administrative për çdo instancë gjyqësore, si dhe për vendime të revokimit ose pushimit.

Në rast pamundësie, të gjitha të drejtat e Presidentit i kalojnë Administratorit të Deleguar, nëqoftëse është i emëruar ose Këshilltarit të përcaktuar nga Këshilli Administrativ.

## **KOMISIONI I REVIZIONIT**

**Neni 28-** Komisioni i Revizionit përbëhet nga tre revizorë efektivë dhe dy zëvendës/revizorë të emëruar në bazë të ligjit.

## **BILANCI DHE TË ARDHURAT**

**Neni 29-** Viti ushtrimor mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo viti Këshilli Administrativ merr masa për hartimin e bilancit të shoqërisë sipas normave ligjore.

**Neni 30-** Të ardhurat neto pasi është hequr një shumë jo më pak se 5% (pesë përqind) si rezervë ligjore, shpërndahen "pro kuota" midis aksionerëve, me përjashtim të rasteve kur Asambleja me propozim të Këshillit Administrativ vendos tërheqje të posaçme në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose ndërrim destinacioni, apo kërkon t'i kalojë të gjitha apo një pjesë në aktivitete të tjera.

**Neni 31-** Pagesa e dividendëve kryhet pranë sporteleve të përcaktuara nga Këshilli Administrativ dhe brenda kufinjve që fiksohen çdo vit nga vetë Këshilli.

**Neni 32-** Dividentët që nuk merren brenda pesë vjetëve nga dita në të cilën bëhen të pretendueshme, kalojnë në favor të Shoqërisë.

## **FALIMENTIMI**

**Neni 33-** Në çfarëdo rasti dhe në çfarëdo kohe të ndodhë falimentimi i Shoqërisë, Asambleja vendos modalitetet e likuidimit dhe emëron një ose më shumë likuidues duke përcaktuar kompetencat dhe pagat e tyre.

**Firmosur Giuseppe GORJUX**  
**President**  
**Firma dhe vula**

*Regjistruar në Gioa del Colle  
në datën 6.2.1998  
me numër 325  
paguar lira 250.000*

*Kopje konform origjinalit, e riprodhuar në 17 (shtatëmbëdhjetë)  
fashikuj dhe që lëshohet për përdorim kompetent.  
Alberobello, 12 marzo 1998*

*Noteri*  
*Firma, vula*

  
KALINOR POLIA  
PUBBLICISTO LEGALE  
LEGAL TRANSLATOR